



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1001/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Prishtinë për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuara ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë

Arsyetim

PZAP-i , më datën 02.12.2013, ka pranuar një ankesë nga LVV me të cilën pretendohet se me datën 01.12.2013 rreth orës 13:30 vëzhguesja e LVV-se Donjeta Asllani është kërcënuar nga Ilmi Retkoceri menaxheri i QV-se 1910E dhe nga një zyrtar policor i panjohur nga LVV-ja ku në momentin kur aktivistet e LVV-se kane shkuar në këtë QV për tju sjellë ushqimin komisionarëve dhe vëzhguesve të LVV-së për këtë QV në këto momente disa militant të LDK-se i kanë penguar aktivistët e LVV-së duke mos i lënë që të hyjnë në objektin e QV-së, dhe në momentin kur vëzhguesja e LVV-se Donjeta Asllani ka dalë që ta marrë ushqimin në atë rast menaxheri i kësaj QV-je Ilmi Retkoceri dhe një zyrtar policor e kane futur brenda në një klasë të zbrazët vëzhguesen e LVV-së duke e kërcënuar dhe duke e urdhëruar që të mos largohet nga vendvotimi. Andaj sipas parashtruesit të ankesës vëzhguesja në fjalë ishte në gjendje të rëndë traumatike ku për këtë dëshmojnë komisionerja dhe vëzhguesi Jehona Kadriu dhe Getoar Morina

PZAP-i kërkoi informacione për rastin në fjale nga Policia e Kosovës Lidhur me rastin në fjalë PZAP-i pranoi raportin policor të datës 04.12.2013 në të cilën theksohet se në shkollën e mesme të mjekësisë rreth orës 12:45 ka ndodhur një mosmarveshje në njërin nga klasat 1910E me ç'rast pala ankuese Donjeta Asllani vëzhguese nga LVV-ja ishte ankuar ndaj Hakif Imerit kryesues i dhomës së larte

cekur te votimit se i njëjti e paska kërcënuar dhe e paska kapur për bisteku të flokut. Ankuesja me këtë rast e ka ndier veten te fyer dhe ka filluar të qajë e ku më pas është njoftuar menaxheri i qendrës votuese Ilmi Ratkoceri i cili fillimisht kishte arritur te bënte marrëveshje në mes palëve të përfshira në këtë rast. Sipas raportit te policisë lidhur me këtë rast nga ana e menaxherit te kësaj QV-je është njoftuar njësia policore e jugut dhe se në vendin e ngjarjes ka dalur prokurorja e shtetit ku pas zhvillimit të intervistave me palët e përfshira në këtë rast është iniciuar rasti në procedurë të rregullt.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore nga ana e LVV-se ne QV 1910E se ka pasur kërcënime nga menaxheri i kësaj QV-je dhe nga një zyrtar policor i panjohur për palën ankuese PZAP-i konsideron si të pabazuara dhe te pa argumentuara nga shkakut se nga raporti policor i datës 04.12.2013 nuk është arritur që të vërtetohet se menaxheri i kësaj qendre te votimit Ilmi Ratkoceri ka kërcënuar vëzhguesen e LVV-së dhe se në asnjë moment nuk është arritur të identifikohet polici për të cilin ka pretenduar pala ankuese në ankesën e saj, andaj veprimet e ndërmara nga PZAP-i në drejtim të vërtetësisë së shkeljes së pretenduar si dhe nga raporti policor shihet se pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe në dëshmi bindës ndërsa për personat e tjerë të përfshirë në këtë rast prokuroria e shtetit ka filluar procedurë të rregullt. Andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1001/2013 më datën 04.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.